REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Situata e zjarreve në Shqipëri: Ministrja Xhaçka falenderon miqtë Evropianë për ndihmën e dhënë gjatë ditëve në nevojë

2021-08-04 21:16:00

Bashkimi Evropian nëpërmjet mekanizmit së mbrojtjes civile #EUCivPro do të nisë drejt Shqipërisë dy helikopterë dhe një ekip me zjarrfikës për të mbështetur operacionet në fikjen e zjarreve. Helikopterët do të vinë nga Çekia dhe Holanda.
Ministrja Xhaçka ka reaguar në rrjetet sociale duke falenderuar miqtë Evropianë për ndihmën e dhënë gjatë ditëve në nevojë.
"Falenderojmë miqtë Evropianë për ndihmën e dhënë gjatë ditëve në nevojë. Mirënjohës ndaj Çekisë dhe Holandës për ekipet që do të na ndihmojnë në shuarjen e zjarreve në vendin tonë. Vetëm të bashkuar mund tja dalim."